



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.16.6-2014-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PROJEKTIN “ZGJERIMI I URËS”**  
**NË MALISHEVË**

*Auditimi sipas Marrëveshjes me UN Habitat Nr. 09/2013*

**Prishtinë, prill 2015**

## 1 Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), sipas marrëveshjes me UN-Habitat, të datës 10 dhjetor 2013 ka kryer auditimin final të raportit financiar për projektin “Zgjerimi i urës” në Malishevë.

Komuna e Malishevës (Komuna) dhe UN-Habitat kanë lidhur marrëveshje me datën 23 prill 2014 për bashkëfinancimin e këtij projekti, ku 50% e projektit duhet të financohet nga Komuna dhe 50% nga UN-Habitat. Kontrata për këtë projekt ishte lidhur me datën 24 qershor 2014 në vlerë prej 74,344€. Marrëveshja e lidhur në mes komunës dhe UN Habitat specifikon se kësti i fundit i pagesës nga UN Habitat do të transferohet pas pranimit të raportit të auditimit të lëshuar nga ZAP.

## 2 Fushëveprimi

Është përgjegjësi e palëve në marrëveshje të përgatisin raportin financiar. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është kontraktuar që të kryejë auditimin e raportit final financiar si dhe ekzaminimin fizik nëse punët janë kryer sipas marrëveshjes.

## 3 Realizimi i projektit

### Përshkrimi

Procedurat e prokurimit<sup>1</sup> për realizimin e këtij projekti ishin zhvilluar nga Komuna. Tenderi ishte zhvilluar me procedurë të hapur dhe kriter për dhënien e kontratës ishte çmimi më i ulët. Me kontratë ishte shpërblyer operatori ekonomik ‘Shqiproni’ nga Klina. Vlera e fillestare e kontratës ishte 74,344€. Për shkak të nevojës për punë të paparashikuara ishte lidhur një aneks kontratë në vlerë 6,659€ që është financuar vetëm nga buxheti komunal.

Për të mbikëqyrur realizimin e punëve, komuna kishte caktuar menaxherin e projektit dhe organin mbikëqyrës, që përbëhej nga tre anëtarë.

Pas përfundimit të punëve, komuna kishte formuar komisionin prej tre (3) anëtarëve për pranimin përfundimtar të punëve. Ky komision kishte bërë pranimin e punëve të projektit me 24.11.2014. Komisioni ka vlerësuar se projekti ka përfunduar dhe punët ishin realizuar sipas kushteve të kontratës, me disa modifikime të nevojshme. Po ashtu, ky komision kishte

---

<sup>1</sup> **Mohim:** ZAP nuk ka audituar procedurat e prokurimit për këtë projekt andaj nuk mban përgjegjësi për çështje që mund të ndërlidhen me këto procedura.

---

vlerësuar se punët janë kryer sipas standardeve ndërtimore të kërkuara dhe mund të shfrytëzhet nga qytetarët.

Ne analizuam nëse projekti është realizuar sipas marrëveshjes në mes të UN-Habitat, Komunës së Malishevës dhe punëkryesit.

### Të gjeturat

Ne kemi vërejtur që punët kanë përfunduar sipas kontratës, ndonëse punimet nuk ishin realizuar sipas dinamikës së përcaktuar me kontratë në afat prej 60 ditësh. Realizimi i projektit ishte vonuar për 69 ditë punë për shkak të pengesave nga disa pronarë të bizneseve të cilët nuk kanë lejuar vendosjen e rrethojave të metalit në afërsi të objekteve të tyre.

Mosvendosja e këtyre rrethojave nuk ka ndikuar në funksionalitetin e projektit. Projekti ka zbukuruar pamjen e mjedisit dhe ofron siguri më të madhe të qarkullimit të këmbësorëve dhe automjeteve, duke i shtuar vlerë hapësirave publike.

Vlera e rrethojave të pavendosura është 1,786€. Kjo shumë është e zbritshme nga totali i financimit, respektivisht 893€ nga pjesa e komunës dhe 770€ (pa TVSH) nga pjesa e UN-Habitatit

Ne kemi vërejtur edhe disa ndryshime jo-materiale të cilat nuk kanë ndikuar në projektin bazë.

UN-Habitat ka transferuar në llogarinë e komunës këstin e parë në shumë prej 11,151€ dhe këstin e dytë në shumën prej 15,638€. Shuma e mbetur prej 4,486€, apo 20% e kontratës duke zbritur shumën 770€ për punët e pakryera për një pjesë të rrethojës, duhet të transferohet pas raportit të auditimit. Gjendja e pagesave është si në tabelën në vijim:

**Tabela: Progresi financiar i projektit (në €)**

Bashkë-financuesi	Kontrata fillestare	Punët shtesë	Obligimi final	Të paguara	Borxhi i mbetur
Komuna e Malishevës	37,172	6,659	43,831	42,938	0
UN-Habitat	32,045 <sup>2</sup>	-	32,045	26,789	4,486€
<b>Totali:</b>	<b>69,217</b>	<b>6,659</b>	<b>75,876</b>	<b>69,727</b>	<b>6,149</b>

### Konkluzion

Ne mund të konkludojmë se ky projekt ka përfunduar me sukses dhe është realizuar sipas marrëveshjes dhe standardeve të kërkuara teknike si dhe me cilësi të mjaftueshme. Projekti ka kontribuar në arritjen e qëllimit të paraparë nga palët kontraktuese.

<sup>2</sup>Detyrimet kontraktuese të Habitat-it janë llogaritur pa vlerën e TVSH

**Rekomandojmë UN-Habitat që:**

- Të transferojë shumën e mbetur 4,486€ në llogari të komunës; dhe
- T'i lëshojë punëkryesit konfirmimin se si organizatë ndërkombëtare është e liruar nga pagesa e TVSH-së.

Annex: Financial Statement



Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës



Project name: "The Mirusha Green Corridor Project"

**FINAL FINANCIAL STATEMENT**

Total CIP Contract value (EUR) 74,344.18  
Total CIP Contract value which is co-funded by UN-Habitat (EUR) 74,344.18

Budget source	EUR
Municipality of Malisheve	37,172.09
UN-Habitat contribution without VAT	32,044.91
Total VAT portion in UN-Habitat's contribution	5,127.18
<b>Total CIP Contracted Project Value incl. VAT</b>	<b>74,344.18</b>

Installments paid by UN-Habitat	EUR	Received on
1st Installment as per AoC	11,151.63	18.07.2014
2nd Installment as per AoC	15,637.71	15.01.2015
<b>Total installments to date</b>	<b>26,789.34</b>	
Total UN-Habitat contribution without VAT	32,044.91	
<b>Total remaining financial obligation of UN-Habitat</b>	<b>5,255.57</b>	

Payments of the Municipality of NAME to the contractor	EUR	Paid on
1st Payment for the contractor NN "Shqiperoni"	11,151.63	19.09.2014
2nd Payment for the contractor NN "Shqiperoni"	15,637.71	20.02.2015
3rd Payment for the contractor NN "Shqiperoni"	-	
4th Payment for the contractor NN "Shqiperoni"	-	
<b>Total Payments</b>	<b>26,789.34</b>	
Total contract value (UN-Habitat's portion without VAT)	32,044.91	
Work not carried out	(770.00)	
<b>Total remaining financial obligation</b>	<b>4,485.57</b>	

Payment schedule according to the Agreement of Cooperation	EUR
1st Installment as per AoC (30%) - <b>(completed)</b>	11,151.63
2nd Installment as per AoC (50%) - <b>(completed)</b>	15,637.71
3rd Installment as per AoC (20%) - <b>(due for payment)</b>	4,485.57